



Në bazë të nenit 163 të Ligjit për Arsim të Lartë (“Gazeta zyrtare e RM-së” nr. 82/18 dhe “Gazeta zyrtare e RMV-së nr.178/21), neni 207 dhe 321 i Statutit të Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup dhe nenit 2 **Rregullore për përcaktimin e kushteve dhe kriterëve për pjesmarrjen e studentëve të Regjistruar në Universitetin “Nënë Tereza” në Shkup në Programin “Punë dhe Studime”** në Universitetin “Nënë Tereza” në Shkup numër 02- /2 e datës 25.01.2024, e lidhur me Vendimin e Drejtorisë Rektoriale të Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup numër 02- /1 të datës .01.2024, Drejtoria Rektoriale e Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup shpall:

KONKURS INTERN

Për angazhimin e studentëve të regjistruar në ciklin e parë në fakultetet e Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, për vitin akademik 2023/2024 edhe atë:

I. Angazhim i studentëve të regullt në programin “Punë dhe Studime:

1. Studentë nga Fakulteti i Shkencave të Informatikës 2 përmbaues

Në programin Punë dhe Studime mund të angazhohet studenti i cili i plotëson kushtet e parapara në Rregulloren për përcaktimin e kushteve dhe kriterëve për pjesmarrjen e studentëve të Regjistruar në Universitetin “Nënë Tereza” në Shkup në Programin “Punë dhe Studime” dhe është student në programin adekuat studimor.

Kriteriumet për aplikim në programin Punë dhe studime:

- studentë aktiv të regjistruar në kuotat shtetërore të cilët kanë treguar sukses të mirë në vitin paraprak akademik;
- studentë të cilët kanë nevojë për ndihmë finaciare dhe e përmbushin kriterin e lartëpërmendur
- studentë të cilët nuk kanë konflikt interesit me udhëheqësinë dhe të punësuarit tjerë në Universitet;

Angazhim i studentit në departamentin përkatës me më së shumti 12 orë në javë gjatë periudhës së ligjëratave dhe më së shumti 18 orë kur nuk ka ligjëratata.

Universiteti ju ofron studentëve ndihmë finaciare përmes mbulimit të pagesës semestrare të studentit të angazhuar në semestrin e caktuar akademik.

Për programin “Punë dhe Studime” studentët do të zgjidhen pas shpaljes së konkursit intern, për vitin akademik 2023/2024.

Studentët të cilët do ta kalojnë fazën prelimiare do të mirren në intervistë nga Komisioni për përzgjedjen e kandidatëve.

Kandidatët duhet të dorëzojnë:

- Fletëparaqitje
- Biografi të shkurtë CV (me kontakt telefon dhe e-mail adresë)



- Dëshmi se është student i rregullt i regjistruar në ciklin e parë të studimeve në vitin akademik paraprak .
- Vërtetim për provimet e dhëna në vitin akademik paraprak;

Dokumentet duhet të dorëzohen në arkivin e Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, rruga 1669 nr.11A kati i 2-të, Shkup.

Me dorëzimin e fletëparaqitjes kandidatët për programin “ Punë dhe Studime” janë dakord për tu regjistruar në bazën e kandidatëve për programin “ Punë dhe Studime” në Universitetin “Nënë Tereza” në Shkup.

Dorëzimi i dokumenteve është së fundmi me 09.02.2024.

Me respekt,

Universiteti “Nënë Tereza” në Shkup